



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") në mbledhjen e vetë të datës xx.yy.2018 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 01/2018

KATEGORIZIMI I PILOTËVE PARAGLLAJDIST SIPAS IPPI STATNARDIT TE FAI DHE KRITERET PËR DEKORIM DHE ARRITJE TË PILOTIT

Për të rregulluar menyrën e shpërndarjes së IPPI kartelave të FAI dhe për të përcaktuar kriteret për dekorim të pilotëve paragllajdist për arritjet e tyre personale, bordi i FAK duke u bazuar standardet e FAI aprovoi këto krutere të vlerësimit:

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Vlerësimi i pilotëve paragllajdist për IPPI kategorizim bëhet një here në vit, zakonisht në muajin Janar. Pas vlerësimit pilotët pajisen me IPPI kartelën e tyre sipas vlerësimit të bërë.
- 1.2 IPPI kartela e pilotit nuk ka afat validiteti, pra është e përgjithshme dhe vetëm pilotët të cilët kanë progres dhe duhet të vlerësohen me një kategori më të lartë se vlerësimi paraprak i tyre duhet të rivlerësohen.
- 1.3 Vlerësimi se nëse janë plotësuar kushtet për dekorim të pilotit paragllajdist bëhet në baza individuale dhe atë vetëm pas aplikimit të pilotit për dekoratë, ky aplikim bëhet në komisionin përkatës të paragllajdistimit në FAK duke i dorëzuar provat për vlerësim pranë këtij komisioni.
- 1.4 Komisioni përkatës për paragllajdistim bashkë me bordin e FAK duhet të shqyrtojë kërkesën për vlerësim dhe të sjellin vendim për dekorim ose jo të pilotit në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe provave të prezantuara nga piloti. Ky vendim duhet të nxjerret dhe piloti të informohet në afatin prej 15 ditëve të punës nga data e aplikimit të pilotit, i njejtë vendim edhe duhet të publikohet në faqen zyrtare të FAK.
- 1.5 Me rastin e dekorimit të pilotit, pilotit i ndahet titulli i dekoratës përkatëse menjëherë, ndërsa vetë dekoratën fizike e cila do "punohet/realizohet" për pilotin dhe kategorinë për të cilën dekorohet, piloti e pranon në ngjarjen e cila organizohet nga FAK çdo fundvit për ndarjen e çmimit "Sportisti i vitit". Kjo dekoratë i dhurohet pilotit nga ana e kryetarit të FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 2.

Kualifikimi për të pranuar vlerësimin IPPI dhe për dekorim

- 2.1 Kriteri minimal që një pilot paragllajdist të kualifikohet për vlerësim të IPPI është që ai/ajo të jetë pilotë i/e licensuar nga Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC) dhe të ketë licensë sportive të FAI.
- 2.2 Kriteri minimal që një pilot paragllajdist të pranojë ndonjë dekoratë është që ai/ajo të jetë pilotë i/e licensuar nga Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC) dhe të ketë licensë sportive të FAI.

Neni 3.

Velësimi i pilotit me IPPI

- 3.1 Në vijim janë kriteret dhe kushtet të cilët duhet të plotësoj piloti për vlerësim sipas standardit IPPI:

IPPI 1 | “FLUTURIM SHKOLLOR”

- Të jetë i licensuar nga Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC).

IPPI 2 | “FLUTURIM BAZIK” (fluturim në kushte të qeta)

- 20 orë fluturim
- Fluturime nga të paktën 3 take-of të ndryshëm

IPPI 3 | “FLUTURIM NË LARTESI” (fluturim në kushte termike, pa turbulenca)

- 100 orë fluturim
- Fluturim në kushte termike pa turbulencë
- Të paktën një (1) fluturim në kohëzgjatje +1 orë

IPPI 4 | “FLUTURIM I ANANCUAR” (fluturim në kushte termike dhe me turbulenca)

- 200 orë fluturim
- Fluturim në kushte termike
- Fluturim në turbulencë
- Të paktën pesë (5) fluturime ne kohezgjatje +1 orë

IPPI 5 | “FLUTURIM NE DISTANCE (CROSS COUNTRY)” (kjo kategori i dedikohet ekskluzivisht fluturimeve XC dhe pilotëve pjesëmarrjes në gara XC)

- 200 orë fluturim
- Të paktën pesë (5) fluturime me distancë minimale 20km
- 3 GOAL të suksesshëm në gara FAI-2



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4.

Dekoratat dhe kriteret e dekorimit të pilotit

3.2 Në vijim janë kriteret dhe kushtet të cilët duhet të plotësoj piloti për dekorim nga FAK:

Medalja e bronzë për paragllajdzëm

- Një (1) fluturim me distancë minimale: 30 km, dhe
- Një (1) fluturim me kohëzgjatje minimale: 1.5 orë, dhe
- Një (1) fluturim me lartësi minimale të fituar: 500 m

Medalja e argjente për paragllajdzëm

- Një (1) fluturim me distancë minimale: 75 km, dhe
- Një (1) fluturim me kohëzgjatje minimale: 3 orë, dhe
- Një (1) fluturim me lartësi minimale të fituar: 1000 m

Medalja e artë për paragllajdzëm

- Një (1) fluturim me distancë minimale: 125 km, dhe
- Një (1) fluturim me kohëzgjatje minimale: 5 orë, dhe
- Një (1) fluturim me lartësi minimale të fituar: 2000 m

Medalja e diamntë për paragllajdzëm

Kjo dekoratë i jepet pilotit për secilën nga këto të arritura të veçanta:

- Fluturim me distancë të lirë: 200 km
- Fluturim me distancë në trekëndësh: 200 km
- Fluturim me lartësi të fituar: 3000 m

Medalja e bronzë për paragllajdzëm në precizion

- Katër (4) aterime të njëpasnjëshme në rreze më të vogël se 1 m nga pika zero

Medalja e argjente për paragllajdzëm në precizion

- Katër (4) aterime të njëpasnjëshme me shumë totale të pikëve më të vogël se 1 m

Medalja e artë për paragllajdzëm në precizion

- Katër (4) aterime të njëpasnjëshme në rreze më të vogël se 10 cm nga pika zero

Medalja diamantë për paragllajdzëm në precizion

- Katër (4) aterime të njëpasnjëshme me shumë totale të pikëve më të vogël se 10 cm

Vërejtje: Katër (4) aterime të njëpasnjëshme nënkuptojnë saktësisht katër (4) fluturime të njëpasnjëshme, ku nuk mund të përjashtohen fluturimet të cilët organizatori i garës i largon nga lista e përgjithshme e kalkulimit të rezultateve, si psh. në rastin e largimit të rezultatit më të dobët të pilotit.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 5. Hyrja në fuqi

7.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, xx.yy.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK